



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.990/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike-përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” sh.a, me seli në Prishtinë, rr. “Hazir Shala”, nr.4, kundër debitorit G.A. Zyra e Avokatit Rr. “Ilir Kunushevci”, Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.12/21 të datës 27.01.2021, të Përmbartuesit Privat Irfan I. Kërçagu me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 18.10.2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit G.A. Zyra e Avokatit Rr. “Ilir Kunushevci”, Prishtinë, ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.12/2021 i datës 27.01.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Irfan I. Kërçagu, me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” sh.a, me seli në Prishtinë, ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.12/21 të datës 27.01.2021, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve të besueshme - Kartela Financiare e Konsumatorit me shifër 141821, me të cilin është obliguar debitori që në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit borxhin prej 1,446.11 Euro, si dhe shpenzimet përmbartimore në përputhje me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014 për Tarifat, Shpërblimet dhe Kompensimin e Shpenzimeve për Përmbartuesit Privat, nëse debitori brenda afatit nuk e përmbush detyrimin e lartshënuar, kreditori ka propozuar që të realizohet me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në xhirollogari bankare të kreditorit nr.... TEB, nëse debitori nuk ka mjete në xhirollogarinë e tij, me konfiskimin dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme të debitorit dhe bartjen e atyre mjeteve në xhirollogarinë e kreditorit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin e kundërshton urdhrin përmbartimor për faktin se kreditori e ka ngarkuar debitorin me

shuma të paarsyeshme të cilat shërbime nuk i ka shfrytëzuar debitori asnjëherë dhe as tani e tutje nuk i shfrytëzon, sepse në zyrën e tij nuk e ka fare të kyçur rrjetin e ujësjellësit, fakt i cili mund të vërtetohet në çdo kohë, por atë shpenzimet janë bërë nga bizneset Kaffe Venezia e cila ka funksionuar deri në fund të vitit 2020, dhe gjendet në pjesën tjetër të objektit, hyrje të veçantë, si dhe një kafe tjetër e cila gjendet në anën e mbrapme të objektit dhe nuk funksionon, të cilat janë furnizuar nga i njëjti njehsor i ujit. Tutja ka theksuar se për herë të parë ka pranuar një faturë për shpenzime të datës 02.09.2015 për shumën e borxhit prej 564.65 Euro, pa e ditur se kah gjithë këto shpenzimet, dhe përkundër se debitori nuk ka qenë pronar i objektit shtëpisë në të cilën ndodhet zyra. Gjykatës i ka propozuara që të aprovohet prapësimi në tërësi si i bazuar, të anulohet si i kundërligjshëm urdhri përmbartimor sepse shpenzimet e krijuara sipas Kartelës Financiare të Konsumatorit nr. ... nuk janë shkaktuar nga debitori por nga subjektet afariste tjera, dhe kërkesa e kreditori të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Kreditori në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazuar, të pa argumentuar si dhe pa mbështetje në prova. Tutje ka theksuar se kreditori të gjithë konsumatorët e vet i faturon në bazë të kodit, dhe në rastin konkret debitori është faturuar në bazë të kodit ..., kjo argumentohet me dokumentin e besueshëm (Kartela financiare) e kreditorit bashkangjitur në propozim për përmbartim, e cila argumentohet se debitori ka pranuar furnizimin me ujë të pijes. Po ashtu kreditori kundërshton deklaratimet e debitorit lidhur me mos dërgimin e faturave mujore, për arsye se dërgimi i faturave mujore debitori i ka pranuar për çdo muaj dhe se njëkohësisht ka bërë pagesa të pjesëshme. Gjykatës i ka propozuar që t'i merr për bazë argumentimet e kreditorit me provat e bashkangjitura dhe të hedhë poshtë prapësimin e debitorit si të pa bazuar dhe të pa argumentuar dhe njëkohësisht të obligohet debitori që të kryej obligimin e tij.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar, andaj, të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaket si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: "*Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në*

*bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Kartela Financiare e Konsumatorit me shifër ..., në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 43 paragrafi 1 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 43 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Në aktvendimin për përmbarimin dhe urdhrin për përmbarim në bazë të titullit përmbarues duhet të tregohet dokumenti përmbarues, kreditori dhe debitori i përmbarimit, kredia që duhet të realizohet, mjeti dhe objekti i përmbarimit, si dhe të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e përmbarimit”*. Me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, kurse sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të LPP-së, ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave janë përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti – Kartela Financiare e Konsumatorit me shifër ..., në bazë të së cilit është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i pranueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk përmban në mënyrë të qartë të dhënat e nevojshme për përmbarim, respektivisht periudhën kohore.

Nga Kartela Financiare e Konsumatorit sipas shifrës ..., rezulton se borxhi në shumën prej 1,446.11 €, është kërkuar për periudhën kohore nga data 01.01.2013 deri me datën 21.01.2021, ndërsa në përmbajtjen Kartelës Financiare të Konsumatorit, nuk është përfshirë fare periudha prej datës 01.01.2013 deri me datën 31.12.2013, me ç’ rast nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm – Kartela Financiare e Konsumatorit me shifër ..., e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi

Privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e Përmbaruesit Privat duhet të anulohet.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.990/22, datë 18.10.2023

Gjyqtari  
Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.